



## KONKURS PËR PUNË

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), është duke kërkuar një kandidat të motivuar që t'i bashkohet ekipit tonë në pozitën:

### **Zyrtar në Departamentin e edukimit dhe standardeve profesionale (DESP)**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Asiston në avancimin e procesit dhe programit të edukimit të ShKÇAK;
- Promovon metoda efektive të edukimit profesional si dhe asiston në zhvillimin, mbikëqyrjen si dhe implementimin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) për anëtarët;
- Përcjell zhvillimet në standardet globale dhe përgatit rekomandimet/ komentet për DESP;
- Asiston në zhvillimin dhe azhurimin e planit strategjik dhe planit të veprimit;
- Bashkëpunon me departamentet dhe komisionet në realizimin e objektivave të ShKÇAK.

Përveç detyrave dhe përgjegjësiave të cekura më lartë Zyrtar -i (-ja) i/e i DESP i ka edhe detyrat dhe përgjegjësitë tjera që ndërlidhen me zhvillimin dhe avancimin e proceseve brenda departamentit të DESP.

#### **Kualifikimet dhe kompetencat:**

- Diplomë universitare;
- Preferohet të jetë së paku i regjistruar në ShKÇAK ose në ndonjë shoqatë tjetër profesionale të njohur ndërkombëtarisht;
- Përvojë të punës në kontabilitet, tatime dhe auditim; hulumtime, projekte zhvillimore;
- Aftësi të mira komunikuese, punës në ekip dhe i gatshëm për punën nën presion;
- Njohja e gjuhës angleze është e domosdoshme;
- Njohuri të avansuar në MS Office;
- Kandidatët kërkohet të kenë vetiniciativë për zhvillim të mëtutjeshëm të plan-programit dhe proceseve brenda departamentit.

Referencat janë të domosdoshme dhe duhet të dërgohen me CV.

**Dorëzoni CV-në tuaj në E-mail adresën: [info@scaak.org](mailto:info@scaak.org)**

**Për pozitën: Zyrtar në Departamentin e Edukimit dhe Standardeve Profesionale**

CV-të i pranojmë deri me 31/08/2023

**Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur**